

URDHËR
Nr. 139, datë 2.7.2021

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 28 dhe nenit 29, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, germës “b” dhe “ç”, të nenit 13 dhe germës “a”, të nenit 21, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë”, si dhe germës “a”, të pikës 1, të nenit 7 dhe germës “a”, të pikës 1, të nenit 30, të Rregullores “për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”, e ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, te znj. Laerta Rooze. Me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për të kryer procedurat dhe nënshkruar aktet në emër të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për marrjen në përdorim të godinës ku ushtron veprimtarinë Kolegji i Posaçëm i Apelimit, sipas përcaktimit në VKM- në nr. 518, datë 29.9.2017, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të një pjese të godinës ku ushtron veprimtarinë Kontrolli i Lartë i shtetit, për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, institucion i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i parashikuar nga ligji nr. 84/2016, VKM-në nr. 230, datë 26.4.2018, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të një pjese të godinës, aktualisht në përgjegjësi administrimi të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për rikonstruksionin e hyrjes kryesore për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit dhe Komisionerëve Publikë, institucione të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe legjislacionit në fuqi.

2. Znj. Laerta Rooze nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit.

4. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Albana Shtylla